


UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT



TEMA - MASTER

**DALLIMET DHE ANALIZA MES VRAPIMEVE 800 METRA TË
LOJËRAVE OLIMPIKE DHE KAMPIONATEVE BOTËRORE TË GJINISË
FEMËRORE**

Mentori:

Prof. Dr. Naser Rashiti

Kandidatja:

Blerina Cena

PRISHTINË, 2017

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE	4
2.	HULUMTIMET E DERITANISHME	7
3.	QËLLIMI I PUNIMIT	11
4.	HIPOTEZAT THEMELORE	12
4.1	Mostra e punës	13
4.2	Mostra e entiteteve	13
4.2.1	Mostra e ndryshoreve specifike vrapimi800m (LO)	13
4.2.2	Mostra e ndryshoreve specifike vrapimi800m (KB)	14
4.3	Burimet e informacioneve të ndryshoreve motorike-specifike (vrapimeve 800)	15
5.	INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI	16
5.1	PARAMETRAT THEMELOR STATISTIKOR	17
5.1.1	Rezultatet e parametrave themelor statistikor të variablave motorike-specifike të atletet në finalen e Lojërave Olimpike 1960-2012	17
5.1.2	Rezultatet e parametrave themelor statistikor të variablave motorike-specifike të atletet në finalen e Kampionatit Botëror 1983-2013	18
5.2	Korrelacioni i variablave motorike-specifike 1960-2012(LO)	19
5.3	Korrelacioni i variablave motorike-specifike 1983-2013(KB)	21
5.4	Dallimet në variablat motorike-specifike 1960-2012 (LO)	23
5.5	Dallimet në variablat motorike-specifike 1983-2013 (KB)	24
5.6	Dallimet në variablat motorike-specifike të Lojërave Olimpikë dhe Kampionatit Botëror	25
6.	HISTOGRAMET E LOJËRAVE OLIMPIKE DHE KAMPIONATIT BOTËROR	27
7.	VËRTETIMI I HIPOTEZAVE	34
8.	PËRFUNDIMI	35
9.	LITERATURA	37
	REZYME	38

SUMMARY

1. HYRJE

Atletika është degë sportive, e cila përfshin format më elementare të lëvizjes. Këto lëvizje kryhen në një seri të formave më shumë ose më pak komplekse, variante dhe disiplinë, çka me evolucion kanë arritur fazën e vet të tanishme të zhvillimit (Schneider dhe Milanović, 1995). Vrapimi është një lloj atletikor, nëpërmjet të cilit realizohet zhvendosja mbi truall nëpërmjet hapave. Atletika funksionon mbi bazën e një sistemi të caktuar të dijeve dhe të shprehive aplikative praktike, që ka në përmbajtjen e saj bazat teorike e metodologjike të mësim-dhënies dhe të stërvitjes sportive¹. Vrapimi i disiplinës të mesme çdo ditë e më shumë po popullarizohet tek masa e gjerë dhe është një sfidë mjaftë e preferuar e atleteve në mbarë botën. Viteve të fundit vërejmë përparime në rezultat në shumë disiplina atletike. Edhe vrapimet 800m. me avancimet e njohurive shkencore dhe aplikimin e tyre në procesin stërvitor tek vrapuesit, bindshëm tregojnë se atletët e përgatitur mirë me lehtësi iu përballojnë kërkesave funksionale dhe motorike që ushtrohen në vrapues gjatë garës². Vrapimi është mjet më universal për përgatitjen e gjithanshme të atletit, por ai zë një vend tepër të rëndësishëm edhe në stërvitjen e llojeve të tjera të sportit. Vrapimet në shtigjet e mesme, të gjata dhe shumë të gjata bëjnë pjesë në grupin e lëvizjeve lokomotorike ciklike. Sipas intensitetit të nxitjeve, vrapimi në shtigjet e mesme bënë pjesë në zonën submaksimale, vrapimi në shtigjet e gjata në zonën e nxitjeve të mëdha dhe të matura, ndërsa vrapimi në shtigjet më të gjata bënë pjesë në zonën e intensitetit të matur³. Evoluimi i rezultateve të mesme tek gjinia femërore gjatë viteve të paraqitura prej viti 1960 deri 2012 në Lojërat Olimpike. Rezultati i vrapimeve të mesme të Kampionatit Botëror gjatë këtyre viteve ka variruar mjaftë shumë. Prej vitit 1983 – 2013 ka pasur një ngritje të theksuar në rezultat. Suksesin e vrapimit në 800m të atleteve elitë duhet kërkuar në faktorët tjerë

¹ Atletika 1, 2004, Tiranë, faq.9

² Atletika , Zagreb, 1986 fae.56

³ Atletika, Ljubljana, 1992, faq.148

antropologjik, në rendë të parë, në aftësit funksionale të cilat janë përgjegjëse për furnizimin e muskujve me oksigjen (O_2). Me dimensione motorike nënkuptojmë ato aftësi të njeriut të cilat marrin pjesë në kryerjen e detyrave motorike dhe kushtëzojnë lëvizje të suksesshme në të gjitha sportet (pra, edhe në sportin e atletikës), pa marr parasysh se a janë fituar aftësitë me anë të trajningut apo jo. Në bazë të hulumtimeve të cilat kanë pasur karakter taksonom në strukturën e hapësirës motorike (faktor të rendit të parë) janë definuar faktorë të tipit akcional (forca, shpejtësia, fleksibiliteti, drejtpeshimi, kordinacioni dhe preciziteti) dhe faktor të tipit topologjik (forca e matur me dinamometër, forca eksplozive, forca repetitive e duarve dhe e krahërorit, forca repetitive e këmbëve, forca repetitive e trupit, forca statike e duarve dhe e krahërorit, forca statike e këmbëve, forca statike e trupit, të vërejturit preciz, gjuajtja precize, drejtpeshimi me sy të mbyllur, drejtpeshimi me sy të hapur, fleksibiliteti, shpejtësia e lëvizjeve të thjeshta, shpejtësia e frekvencionit, shpejtësia e të mësuarit të detyrave të reja motorike, koordinimi në ritëm, agjiliteti, riorganizimi stereotip i lëvizjeve, shpejtësia e ekzekutimit të detyrave komplekse motorike, koordinimi i tërë trupit, koordinimi i duarve, koordinimi i këmbëve⁴. Shumica e aftësive psikomotorike fitohen dhe zhvillohen kryesisht në periudhën e fëmijërisë. Në këtë periudhë të zhvillimit ndërtohet dhe zhvillohet struktura e hapësirës motorike ndërsa pas periudhës së pubertetit (16 – 18 vjeçare) fillon të stabilizohet (Metikos, 1974, Kurelic me bashk., 1975, Bala, Kis dhe Popovic, 1996).

Vrapimi është një lloj atletikor, nëpërmjet të cilit realizohet zhvendosja mbi truall nëpërmjet hapave. Ky ushtrim është i thjeshtë dhe mund të kryhet pothuajse nga të gjithë kategoritë e moshave. Vrapimi është një mjet bazë për përgatitjen fizike dhe zhvillimin e organizmit. Ai ndihmon për të përballuar ngarkesa stërvitore të larta. Vrapimi është mjet më universal për përgatitjen e gjithanshme të atletit, por ai zë një vend tepër të rëndësishëm edhe në stërvitjen e llojeve të tjera të sportit. Vrapimet në shtigjet e mesme, të gjata dhe shumë të gjata bëjnë pjesë në grupin e lëvizjeve lokomotorike ciklike.

⁴Atletika, 1991, Novi Sad faq.8

Sipas intenzitetit të nxitjeve, vrapimi në shtigjet e mesme bënë pjesë në zonën submaksimale, vrapimi në shtigjet e gjata në zonën e nxitjeve të mëdha dhe të matura, ndërsa vrapimi në shtigjet më të gjata bënë pjesë në zonën e intenzitetit të matur.⁵ Motivet për një aktivitet të tillë janë të llojllojshme duke filluar prej atyre argëtuese, dëfruese, rekreative dhe garuese. Lirisht mund të themi se shumica e sporteve burim kryesor i kanë vrapimet ku kërkohet angazhim maksimal ku qëllimi kryesor është që përmes garave të arrihet deri te rezultati⁶. Lëvizjet njerëzore shumë shkencëtar që i kanë studiuar këto lëvizje dhe dukuritë e tjera por lënda “Teoria e lëvizjes njerëzore” ka objektivat e veta specifike të emërtura “aktivitete motore njerëzore” që shpreh vetëm dukuritë lëvizore si tërësi e nivelit të saj.⁷Përmes vrapimeve arrihet transformimi i karakteristikave antropologjike, morfologjike, kognitive, konative e sidomos atyre motorike dhe motorike situacionale⁸.

Rëndësi të madhe në hulumtimet e relacioneve antropologjike të rezultateve atletikore kanë dhanë shume autor: Kohlrausch, 1924, Mc Cloy 1932, Ozolin 1949, Hill 1950, Genov 1953, Bruscler 1957, Godnik Zaciorskij 1962 Hoffman 1962, Clarke dhe Glinse 1962, tittel 1963, Matvejev 1964, Khosla 1968, Wutacherk 1969, Tumanjan dhe Shenkova 1970, dribisch 1972, Harlicek 1972Shpolas 1977, Wazny 1978 Ballreich 1978 Milanovic 1979 Shnajder 1982 etj.

⁵ Teoria a didaktika atletiku, Bratislava,1987, faq.59

⁶ Atletika 1, 1992, Beograd, faq.33

⁷ Teoria e Lëvizjes, 2001, Tiranë, faq.7

⁸ Atletika Bazat e Stërvitjes Sportive, Tiranë,2007, faq.59

2. HULUMTIMET E DERITASHME

Kohëve të fundit është në rritje numri i punimeve nga autorë të ndryshëm në trajnimin e hapësirës së aftësive motorike në popullatën e të rinjëve të moshave të ndryshme. Në trevat tona hulumtimet në popullatat e të rinjëve, pavarësisht nga tretmani kineziologjik është ende i vogël, e në shumicën e hulumtimeve deri më tani kjo problematikë është trajtuar në mënyrë segmentare. Hulumtimet e kohës së fundit në hapësirën morfologjike flasin për ekzistimin e së paku katër dimensioneve latente: dimensionin i rritjes longitudinale të skeletit, dimensionin i rritjes transversale të skeletit, dimensionin i masës dhe vëllimit të trupit dhe dimensionin i indit dhjamor nënlëkuror të trupit. Hulumtimet në trevën tonë janë orientuar më tepër në fushat e morfologjisë dhe motorikes, ku kanë shqyrtuar strukturën faktoriale, lidhshmëritë dhe ndikimet e këtyre fushave me dukuritë e sporteve të ndryshme. Në shumë hulumtime të deritashme, në mostra të popullatës shkollore, është vërtetuar ekzistimi i dimensioneve antropometrike dhe motorike, por që ato ndryshojnë në varshmëri nga mostrat përkatëse. Në dy dekadat e fundit ekziston një numër relativisht i madh i eksperimenteve me nxënës të grupmoshave të ndryshme, sidomos të atyre prej 10 – 14 vjeç. Megjithatë, në bazë të literaturës që kanë shfrytëzuar, në vijim do të përshkruajmë disa hulumtime të cilat si objekt studimi kanë pasur vërtetimin e karakteristikave morfologjike dhe si dhe relacionet e tyre me aftësitë motorike të nxënësve në mostra përafërsisht të njëjta, me mostrën e këtij hulumtimi.:

Zbulimet e reja treguan se **Leonardo Da Vinçi** 1452-1519 ka studiuar mbi teorinë e mekanikës, Ai i studioj ligjet e fizikës njerëzore duke u mbështetur mbi të dhënat e anatomisë e të mekanikës. Leonardo Da Vinçi e kuptoi në mënyrë perfekte se “pozita dhe lëvizja e trupit të njeriut janë të ndërtura mbi ligjet e mekanikës”, “Shkenca e mekanikës është më e dobishmja nga tërë shkenca sepse edhe organizmat e gjalla duke pasur vetinë e të lëvizurit i binden ligjeve të saj. **Da Vinçi**

Autori rus **Donsko.** (1963), në librin “Teknika Sportive” me termin “Teknik” nënkupton: “një sistem lëvizjesh të specializura, racionale dhe qëllimore, të bashkërendura sipas një rradhe dhe kohëzgjatje të caktuar”.

Dibra F. (2011), në hulumtimin e tij të teknikës atletikore nënvizon se: “Lëvizjet atletikore, nënkuptojm një tërësi lëvizjesh fizike e qëllimore, që i nënshtrohen ligjeve të fizikës dhe biomekanikës.

Në hulumtimin e një grupi autorësh (1971), në mostrën prej 6330 nxënësve të të dy gjinive, të grupmoshave prej 11 – 17 vjeç, kanë aplikuar 18 variabla antropometrike dhe 36 motorike. Në submostrën e grupmoshave prej 11 – 15 vjeç, kanë vërtetuar faktorizimin e dy dimensionave latente në hapësirën antropometrike të definuar me faktorin e masës dhe vëllimit me indin dhjamor nënlëkuror, dhe faktorin dimensional longitudinal me atë transversal të skeletit.

Kasa A. (2001), në eksperimentin me fëmijët e moshës 10 – 14 vjeç, nga Tirana (meshkuj dhe femra), analizon gjendjen e aftësive të përgjithshme motorike dhe bën krahasimin e tyre me moshatarët e vendeve tjera. Në bazë të rezultateve të eksperimentit ka rezultuar se fëmijët tanë janë në të njëjtin nivel me ata të vendeve tjera, në shumicën e elementeve psikofizike, me një ngecje të theksuar në rregullimin struktural të lëvizjeve, respektivisht në testet e koordinimit.

Ganev. (1953), gjatë eksperimentimeve me atletë të grupit të kërcimeve, vëren se rezultatet teknike varen edhe nga disa faktorë të pjesshëm morfologjikë. Mbi bazën e analizave statistikore, ai konstaton se: ndikime me vlerë në rezultatet më të mira të provave të kërcimeve, arrihen kur gjatësia trupore e kërcyesit arrin treguesit, $r=.53$, gjerësia e supeve, konsumit maksimal të oksigjenit. Çebriç, arrin në disa lidhje të ngushta ndërmjet këtyre faktorëve për zhvillimin e forcës së disa muskujve, në rajonet kryesore të trupit, sidomos të muskujt.

Gajiç. (1986), ka hulumtuar ndryshimet e koordinimit, të forcës eksplozive dhe fleksibilitetit në periudhën e ontogjenezës prej 11 deri më 14 vjeç. Përcjellja longitudinale është realizuar në mostër prej 200 nxënësve dhe 223 nxënësve në klasën e pestë të shkollës fillore. Matjet janë realizuar 5 herë me ndihmën e 18 testeve

motorike për vlerësimin e forcës eksplozive, 13 për vlerësimin e fleksibilitet, 15 për vlerësimin e koordinimit dhe 9 për vlerësimin e vëllimit të lëvizjeve në nyjet. Nga numri i madh i informatave, të cilat i ka mundësuar ky hulumtim, për këtë punë është interesante numri dhe struktura e dimensioneve motorike të fituara. Izolimi i numrit të dimensioneve të rëndësishme nuk ka qenë plotësisht i njëjtë, si dhe struktura e tyre, sipas gjjinisë ashtu edhe sipas pikave matëse. Në bazë të rezultateve të këtij hulumtimi, autorët konkludojnë se në këtë periudhë të fëmijët paraqiten këta faktorë motorikë. 1).Aftësia për zgjidhjen e shpejtë të detyrave të komplikuara motorike; 2).Koordinimi në ritëm; 3).Koordinimi i këmbëve; 4).Aftësia për amplitudë të lartë të lëvizjes së nyjeve në këllqë; 5).Elasticiteti i kushinetës së këllkut; 6).Elasticiteti i gjithë trupit; 7).Lëvizshmëria e trupit; 8).Elasticiteti i iliopsoasit; 9).Elasticiteti i muskujve të krahërorit; 10).Lëvizshmëria e nyjeve të këllkut; 11).Lëvizshmëria e trupit; 12).Forca eksplozive; 13).Forca eksplozive e ekstremiteteve të larta; 14).Forca eksplozive e karakterit goditës; 15).Aftësia për lëvizjet e shpeshta të karakterit eksploziv, 16). Forca eksplozive e muskujve 17). Strukturimi i lëvizjeve eksplozive.

Rashiti N. (2004)⁹, Një hulumtim të tillë është bërë nga ky autor që ka pasur për bazë hulumtimin e shtatëgarshit atletikor, ku ka bërë krahasimin e analizës krahasuese të Kampionatit Botëror të vitit 2001, mostra e të anketuarve ka qenë 120 atletë të kategorisë seniore dhe juniore nga ranglista botërore, ky kampionat u mbajt në Edmonton.

$r=.44$ dhe gjatësia e këmbës, nën gju, në $R=.43$.

Titel-i (1972), studion lidhjet pozitive ndërmjet rezultateve teknike në kërcimin së gjati, të madhësisë së pjesshme dhe të plotë të pjesëve të trupit. Në eksperimentimet e tij, me 30 kërcyes cilësor, nëpërmjet analizës regressive, ai ka zbuluar disa varësi pozitive mbi rezultatet e kërcimit së gjati, lidhur me masën, peshën dhe lartësinë trupore të kërcyesit: lartësia 181-182 cm dhe pesha trupore, minus 10-12 njësi.

Çebriç. (1997), procesin e përgatitjes së forcës, e lidh edhe me faktorë të tjerë, duke përmendur ato me karakteristika fiziologjike. Duke studiuar praktikën stërvitore të disa

⁹ RASHITI;N. "Studime Sportive" 4/2004 faq. 64.

atletë cilësorë, në sprintet dhe kërcimin së gjati, ai përcakton strukturën faktorizuese, në këndvështrimin somatik, funksional dhe motorik, si dhe në aspektet energjetike dhe të

Rashiti N.¹⁰ Me këtë mostër të garuesëve nëpërmjet 4 ndryshoreve janë analizuar parametrat themelor statistikor dhe në bazë të matricës së korelacioneve është vërejtur lidhshmërija në mes dy ndryshoreve (lartësis dhe peshës) në nivel $p < 0.001$. Në bazë të analizës regresive në këtë hulumtim është vërtetuar se rezultati i vrapimit maratonik statistikisht nuk është i varur nga ndikimi i parametrave antropometrik të aplikuar në këtë punim. Suksesin e vrapimit maratonik duhet kërkuar në faktorët tjerë antropologjik, në rendë të parë në aftësit funksionale aerobe.

Lëvizja është pjesë e teknikës. Njohja mirë e saj përbën një faktor kryesor për mësimin , përvetësimin dhe përsosjen e teknikave atletikor.

¹⁰ RASHITI ;N."INFLUENCE OF BODY HEIGHT, BODY WEIGHT AND THE AGE ON THE RESULTS ACHIEVED BY FEMALE-MARATHONERS IN A MARATHON RACE" Skopje, Makedonija 2/2011, FAQ.17.

3. QËLLIMI I PUNIMIT

Duke u nisur nga fakti se vlerësimet subjektive të një profesori nuk mund të nxjerrin një përfundim të saktë mbi angazhimin real të atleteve elitë gjatë përgaditjes së garimit, është e nevojshme që vlerësimet në këtë drejtim të bëhen në bazë të rezultateve të fituara nga matjet e aftësive specifike të vrapimit 800 metra të gjinisë femërore.

Qëllimi kryesor i hulumtimit është që të vërtetohet gjendja faktike e vrapimeve në 800 metra dhe dallimi në mes **Lojërave Olimpike**: ([Roma](#),[Tokyo](#), Mexico,[Munich](#),[Montreal](#), [Amsterdam](#), [Los Angeles](#), [Seoul](#),[Barcelona](#), [Atlanta](#), [Sydney](#), [Athens](#), [Beijing](#) dhe [London](#)) si dhe hulumtimi që të vërtetohet gjendja faktike e vrapimeve në 800 metra dhe dallimi në mes **Kampionateve Botërore**,([Helsinki](#), [Rome](#), [Tokyo](#), [Stuttgart](#), [Gothenburg](#), [Athens](#), [Seville](#), [Edmonton](#), [Saint-Denis](#), [Helsinki](#), [Osaka](#), [Berlin](#) , [Daegu](#) dhe [Moscow](#))

4. HIPOTEZAT THEMELORE

Në bazë të hulumtimeve të deri tanishme të cilat kanë trajtuar strukturën e hapësirës specifike (vrapimit në distancë 800 metra tek gjinia femërore) si dhe në bazë të qëllimit të hulumtimit, mund të parashtrohen këto hipoteza:

H1- Supozojmë që nuk do të ketë shmangie të rëndësishme prej distribucionit normal në vrapimin 800m. të Lojërat Olimpike 1960 -2012, të gjinisë femërore.

H2- Supozojmë që nuk do të ketë shmangie të rëndësishme prej distribucionit normal në vrapimin 800m. të Kampionatit Botëror 1983 -2013, të gjinisë femërore.

H3- Supozojmë se matricën e Lojërave Olimpike të interkorrelacionit të variablat specifike (vrapimet 800 metra) në mes veti do të kenë lidhje statistikore të lartë, me një korelacion shumë të lartë pozitiv.

H4- Supozojmë se matricën e Kampionatit Botëror të interkorrelacionit të variablat specifike (vrapimet 800 metra) në mes veti do të kenë lidhje statistikore të lartë, me një korelacion shumë të lartë pozitiv.

H5- Supozojmë se do të ketë dallime të rëndësishme në vrapimet 800 metra në mes Lojërave Olimpike dhe Kampionatit Botëror të gjinisë femërore.

4.1 Mostra e punës

4.2 Mostra e entiteteve

Mostra e këtij punimi përfshinë 14 kampionate të Lojërave Olimpike 1960-2012 janë përfshirë të gjitha atletet e Lojërave Olimpike të gjinisë femërore në 800 metra, 788 garuese Olimpike.

4.2.1 Mostra e ndryshoreve specifike vrapimi 800metra (Femërore)

Nr.	Simboli	Ndryshoret specifike
1.	V800/60	Vrapimi i 800 1960 Roma Itali
2.	V800/64	Vrapimi i 800 1964 Tokyo
3.	V800/68	Vrapimi i 800 1968 Mexico
4.	V800/72	Vrapimi i 800 1972 Munich
5.	V800/76	Vrapimi i 800 1976 Montreal
6.	V800/80	Vrapimi i 800 1980 Amsterdam
7.	V800/84	Vrapimi i 800 1984 Los Angeles
8.	V800/88	Vrapimi i 800 1988 Seoul,
9.	V800/92	Vrapimi i 800 1992 Barcelona
10.	V800/96	Vrapimi i 800 1996 Atlanta
11.	V800/00	Vrapimi i 800 2000 Sydney
12.	V800/04	Vrapimi i 800 2004 Athens
13.	V800/08	Vrapimi i 800 2008 Beijing

14.	V800/12	Vrapimi i 800 2012 London
------------	----------------	---

4.2 Mostra e entiteteve

Mostra e këtij punimi përfshinë 14 gara të Kampionatit Botëror 1983-2013 janë përfshirë të gjitha atletet e gjinisë femërore në 800 metra, 852 garuese të Kampionatit Botëror.

4.2.2 Mostra e ndryshoreve specifike vrapimi(Femërore)

Nr.	Simboli	Ndryshoret specifike
1.	V800/83	Vrapimi i 800m Helsinki 1983
2.	V800/87	Vrapimi i 800m Rome 1987
3.	V800/91	Vrapimi i 800m Tokyo 1991
4.	V800/93	Vrapimi i 800m Stuttgart 1993
5.	V800/95	Vrapimi i 800m Gothenburg 1995
6.	V800/97	Vrapimi i 800m Athens 1997
7.	V800/99	Vrapimi i 800m Seville 1999
8.	V800/01	Vrapimi i 800m Edmonton 2001
9.	V800/03	Vrapimi i 800m Saint-Denis 2003
10.	V800/05	Vrapimi i 800m Helsinki 2005
11.	V800/07	Vrapimi i 800m Osaka 2007
12.	V800/09	Vrapimi i 800m Berlin 2009
13.	V800/11	Vrapimi i 800m Daegu 2011

14.	V800/13	Vrapimi i 800m Moscow2013
-----	---------	---

4.3 Burimet e informacioneve të ndryshoreve motorike-specifike (vrapimeve 800 metra)

Rezultatet e variablave antropometrike, kalendarike dhe specifike, (vrapimeve në distance të shkurta të mesme) do të paraqiten në vijim me qëllim të transparencës shkencore. Finalen.wikipedia.org/wiki/1983_World_Championships_in_Athletics_-_Women%27s_800_metres

Finalen..wikipedia.org/wiki/2013_World_Championships_in_Athletics_-_Women%27s_800_metres

wiki/Athletics_at_the_1960_Summer_Olympics_-_Women%27s_800_metres [Rome, Italy](#)

wiki/Athletics_at_the_2012_Summer_Olympics_-_Women%27s_800__metres [London, United Kingdom](#)

5. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI

Në bazë të qëllimit dhe hipotezave të parashtruara, do të aplikohen metodat e përpunimit të rezultateve të cilat mundësojnë sigurimin e informatave të mjaftueshme për realizimin e qëllimit.

Për realizimin e këtij punimi do të llogariten parametrat themelorë statistikorë dhe të shpërndarjes për secilën variabël, si dhe masat e asimetrisë dhe të shpërndarjes normale:

- Vlerat minimale dhe maksimale (R.min-R.maks)
- Mesatarja aritmetikore (Ma)
- Devijimi standard(Ds)
- Parametrat e asimetrisë (SKEW dhe KURT)

Raportet e ndërlidhjeve ndërmjet variablave në hapësirën manifeste, si dhe korrelacionet ndërmjet sistemit të variablave.

Për percaktimin e dallimit ndërmjet variablave specifike (vrapimeve të mesme 800 ,metra të gjinisë femërore) të dy Lojërat Olimpike dhe Kampionatit Botërore, do të aplikohet **analiza discriminative e T-testit**

5.1. PARAMETRAT THEMELOR STATISTIKOR

5.1.1. Rezultatet e parametrave themelor statistikor të variablave motorike-specifike të atleteve në Lojërat Olimpike 1960-2012 (800metra)

Në tabelën 1 janë paraqitur parametrat themelor statistikor të ndryshoreve motorike te atletet elitë. Mostra ka përfshirë 14 Lojëra Olimpike, ku janë të përfshirë atletët të Lojërave Olimpike gjithsej 788 atletë, ku janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – asim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet).

Tab.1	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skewness	Kurtosis
LO1960	34	124.50	148.40	130.3659	4.33739	2.185	8.235
LO1964	47	121.10	142.70	128.5426	4.75220	1.190	1.413
LO1968	53	120.90	133.50	126.7726	2.84776	.068	-.140
LO1972	52	118.93	139.69	124.3962	4.27098	2.032	4.553
LO1976	60	114.94	134.39	121.1435	3.70203	.994	1.785
LO1980	52	113.50	153.40	122.5712	7.48165	2.185	5.334
LO1984	48	117.60	138.79	123.5037	4.21781	1.725	3.736
LO1988	53	116.10	132.18	121.7647	3.45544	.938	1.275
LO1992	58	115.54	149.77	122.1626	6.59418	3.006	9.594
LO1996	49	117.73	156.85	123.4876	7.29090	3.390	12.696
LO2000	66	116.15	151.71	123.5764	6.44150	1.993	4.815
LO2004	74	116.39	152.10	122.7673	5.97627	2.817	9.670
LO2008	70	114.82	150.14	121.5504	5.70870	3.163	11.491
LO2012	72	116.19	164.95	124.5333	8.33267	2.592	8.348

Mesatarja aritmetikore e variablës vrapim në 800 metra (LO 1960..2012) Kemi një ndryshore specifike – motorike në vrapimin 800 metra për femra që nuk ka shmangia nga distribucionit normal LO 1964, kurse te gjitha ndryshoret e asimetria e fituar tregon se vlerat e fituara kanë shmangie prej distribucionit normal, çka do të thotë se nuk ekziston një dallim i madh në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, Arsyeja kryesore

është se në këtë hulumtin janë përfshirë atletet elitë por të gjitha këto nuk janë finaliste dhe rezultatet dallojnë minimal dhe ai maksimal kështu që është bërë shpërndarja e rezultateve.

5.1.2. Rezultatet e parametrave themelor statistikor të variablave motorike- specifike të atlete në finalën e Kampionatit Botëror 1983-2013

Në tabelën 2 janë paraqitur parametrat themelor statistikor të ndryshoreve motorike të atletet elitë. Mostra ka përfshirë 14 Kampionate Botërore,ku janë të përfshir atletet e Kampionatit Botëror,gjithsej 852 atletë, ku janë të paraqitur a vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – asim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet)

Tab.1	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skewness	Kurtosis
KB1983	56	114.68	175.64	124.9780	9.62148	2.939	13.138
KB1987	50	116.65	132.20	122.0978	3.33003	.956	1.634
KB1991	56	115.43	128.72	122.0807	2.83437	.504	.259
KB1993	52	117.31	143.19	123.0133	5.32846	1.934	3.798
KB1995	58	116.11	163.22	123.1834	8.00208	3.601	14.276
KB1997	59	117.14	156.18	123.7083	6.79853	2.837	9.657
KB1999	60	116.68	139.79	121.3373	3.45737	2.930	13.348
KB2001	54	117.17	147.96	122.6787	4.63816	3.492	16.851
KB2003	71	118.45	147.96	122.9087	4.37240	3.792	17.515
KB2005	65	120.23	138.75	125.1568	3.91446	1.581	3.003
KB2007	76	116.04	156.14	122.4176	7.01413	3.336	12.096
KB2009	73	115.45	151.94	123.5840	5.72247	3.101	12.139
KB2011	66	115.87	156.36	121.6427	5.07796	5.151	34.178
KB2013	56	117.38	131.21	120.8861	2.59411	2.453	7.565

Mesatarja aritmetikore e variablës vrapim në 800 metra (KB 1983...2013) kemi vetëm një ndryshore specifike – motorike në vrapimin 800 metra për femra që nuk ka shmangie nga distribucioni normal KB 1993, kurse të gjitha ndryshoret e asimetria e fituar tregon se vlerat e fituara kanë shmangie të rëndësishme prej distribucionit normal,

çka do të thotë se nuk ekziston një dallim i madh në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal. Arsyeja kryesore është se në këtë hulumtim janë përfshir atletet elite por të gjitha këto nuk janë finaliste dhe rezultatet dallojnë minimal dhe ai maksimal kështu që është bërë shpërndarja e rezultateve.

5.2 KORRELACIONI I VARIABLAVE MOTORIKE–SPECIFIKE TË LOJËRAVE OLIMPIKE 1960-2012

Në tabelën 3 janë të paraqitura koeficientët e korelacionit apo ndërlidhjes ndërmjet e variablave motorike – specifike të Lojërave Olimpikë. Për shkak të pasqyrimit më të mirë të tabelës dhe për të vërejtur më qartë koeficientet e interkorrelacionit, koeficientet e rëndësishme të niveleve të ndryshme të lidhmërisë, janë evidentuar me shenjen e yllit. Kështu që koeficientet statistikisht të rëndësishëm të variablave me shkallë më të lartë të konkludimit statistikor ($p < 0.01$) janë shënuara me dy shenja të yllit. Me kriteri më të lehtë të konkludimit statistikor ($p < 0.05$) koeficientet e korelacionit janë shënuara me një shenjë të yllit. Interpretimi i koeficientëve të korelacionit të thjeshtë linear siq është e njohur në të shumtën varet nga numri i të testuarve, respektivisht më preciz nga shkalla e lirisë. Për mostrën prej 163 të testuarve tek atletët elitë numri i shkallës së lirisë është 38. Me inspektimin e tabelës të vlerave të kufizuara koeficientët e Pirsonit vërehet se vlera e kufirit për 99 shkallë të lirisë është $r = 0,217$ me kriterium më të lehtë ($p = 0,05$) respektivisht $r = 0,283$ me kriterium më të ashpër të konkludimit statistikor ($p = 0,01$) (Bala, 1990). Shikuar në përgjithësi matricen e interkorelacionit e sidomos koeficientët e korelacionit brenda sajë vërejmë se ato janë mjaft homogjene dhe të grupuara sipas ngjajshmërisë së matjeve të parametrave motorik-specifike në Lojërat Olimpikë 1960-2012. Interpretimi i koeficientëve të korelacionit të thjeshtë linear siq është e njohur në të shumtën varet nga numri i të testuarve, respektivisht më preciz nga shkalla e lirisë. Për mostrën prej 788 të testuarve tek volejbolliste numri i shkallës së lirisë është 48. Me inspektimin e tabelës të vlerave të kufizuara koeficientët e Pirsonit vërehet se vlera e kufirit për 48 shkallë të lirisë ($df(N-2)$) është $r=0.304$ me kriterium më të lehtë ($p=0.05$) respektivisht $r=0.393$ me kriterium më të ashpër të

konkludimit statistikor ($p=0.01$) (Bala, 1990). Korelacioni më i lart është 655** kurse ai më i ulit është 272*.

Tab.3	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
LO1960	1	.183	-.076	-.065	-.307	-.421*	-.355*	-.370*	-.411*	-.294	.530**	-.469**	-.422*	-.175
LO1964	.183	1	.391**	.351*	.229	-.106	-.160	-.249	-.126	-.267	.201	-.258	.108	-.053
LO1968	-.076	.391**	1	.175	.083	-.188	-.283	-.146	-.006	-	-.025	-.180	.301*	.148
LO1972	-.065	.351*	.175	1	.655**	.109	.235	.054	.371**	-.076	-.020	-.083	.127	.009
LO1976	-.307	.229	.083	.655**	1	.158	.167	-.101	-.079	-.016	-	.025	.011	.125
LO1980	-.421*	-.106	-.188	.109	.158	1	.294*	.277*	.454**	.258	.163	-.092	.162	-.190
LO1984	-.355*	-.160	-.283	.235	.167	.294*	1	.429**	.351*	.193	-.118	.465**	.178	.047
